



REPUBLIKA E KOSOVËS - РИПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 qershor 2012
Nr.Ref.:RK257/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 19/12

Parashtruesi

Naser Peci, avokat i cili e përfaqëson të ndjerin Murat Plakolli

**Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së
Qarkut në Prishtinë AC.nr. 1496/2011 të 24 janarit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Naser Peci, avokat nga Prishtina i cili e përfaqëson përkohësisht të ndjerin Murat Plakolli.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik është Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC.nr. 1496/2011 i 24 janarit 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës me datë 22 shkurt 2012.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC.nr. 1496/2011 i 24 janarit 2012, lidhur me patundshmërinë e lënë në hipotekë nga i ndjeri Murat Plakolli.
4. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të mos i zbulohet identiteti.

Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë

5. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC. nr. 1496/2011 i datës 24 janar 2012, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullit 28 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 28 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, dhe e njëjta u regjistrua me nr. KI 19/12.
8. Më 29 shkurt 2012, Kryetari, me vendimin GJR. KI 19/12 caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë Kryetrari me vendimin KSH. KI 19/12 caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: 1. Altay Suroy (kryesues), 2. Dr. Gjyljeta Mushkolaj (anëtare) dhe 3. Dr. Iliriana Islami (anëtare).
9. Më 13 mars 2012, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i përkohshëm i të ndjerit që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin nga trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Murat Plakolli, që do të provonte se i njëjti është i autorizuar për përfaqësim të kësaj çështje në Gjykatë.
10. Më 19 mars 2012 Gjykata, njoftoi Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për regjistrimin të kërkesës.
11. Më 20 mars 2012, përfaqësuesi i përkohshëm i të ndjerit, i është përgjigjur kërkesës së gjykatës dhe ka pohuar që i njëjti ishte caktuar me aktvendimin e Gjykatës Komunale

në Prishtinë E.nr 1168/10 të 19 korrikut 2011. Për caktimin e tij gjykata është mbështetur në nenin 36.4 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), nenin 82 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Përfaqësuesi i të ndjerit mendon se, ky ligj aplikohet edhe për çështjet tjera që nuk i rregullon (LPP), ndër të tjera në përgjigjen e tij thuhet: *Unë mbi bazën e aktvendimit të Gjykatës e kam për obligim që të ndjerin Murat Plakolli ta përfaqësoi lidhur me çështjen, derisa gjykatës nuk i paraqiten trashëgimtarët e të ndjerit personalisht apo i autorizuari i tyre me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë nuk cakton kujdestarin sipas kërkesës së gjykatës.*

12. Më 20 qershor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 21 korrik 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë në bazë të Konkluzionit mbi Shitjen me nr. E. nr. 1168/10, përmes ankandit të dytë publik, caktoi shitjen e patundshmërisë së të ndjerit, (debitori-garantuesi) e regjistruar në fletën poseduese UL-71914059, e evidentuar si ngastër kadastrale me nr. 1994-O, sipas kulturës shtëpi dhe oborr, në vendin e quajtur Kolonia e re ZK Prishtinë, në sipërfaqe prej 224 m².
14. Më 21 korrik 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë, nxori Aktvendimin E.nr.1168/10 me ç'rast miratoi propozimin e paditësit (Pro Credit Bank), për caktimin e një përfaqësuesi të përkohshëm që ta përfaqësonte z. Murat Plakolli, pasi që i njëjti kishte vdekur më 2 prill 2010. Gjykata, më pas, si përfaqësues të përkohshëm e kishte caktuar z. Naser Peci, përderisa trashëgimtarët e të ndjerit apo i autorizuari i tij të paraqiteshin në Gjykatë, e që më pas i njëjti do t'i ketë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjorë. Ndaj këtij Aktvendimi Gjykata nuk ka lejuar të ushtrohet e drejta për ankesë.
15. Më 8 gusht 2011 përfaqësuesi i përkohshëm z. Naser Peci, dorëzoi një parashtresë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ku kishte kërkuar që Gjykata Komunale të vlerësojë edhe një herë Aktvendimin E.nr.1168/10 të 21 korrikut 2011, lidhur me caktimin e tij si përfaqësues i përkohshëm në këtë çështje juridike, për faktin se, siç pohon i njëjti në parashtresën e tij: "dispozita e nenit 36 paragrafi 4 i LPP saktëson se, debitorit i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm vetëm në rastin kur nuk ka përfaqësues të autorizuar apo "përfaqësues ligjor", edhe radha e caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm është saktësuar, pra nga radha e personave që janë në posedim të pronës.
16. Më 12 shtator 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë në bazë të Konkluzionit E.nr.1168/10 për Shitjen e patundshmërisë nr. UL-71914059-04949, pronë e debitorit garantuesit Murat Plakolli (hipotekëlënë), përcaktoi se kreditori Pro Credit Bank, si blerës, ishte ofertuesi më i volitshëm që ka ofruar çmimin më të lartë të blerjes së patundshmërisë në fjalë.
17. Më 6 tetor 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë, nxori Aktvendimin E.nr.1168/10 me ç'rast konstaton se, patundshmëria e lënë në hipotekë nga i ndjeri, i është shitur kreditorit Pro Credit Bank, si ofertues i vetëm, me i volitshëm dhe që ka ofruar çmimin

më të lartë për blerjen e kësaj pronë të paluajtshme. Debitori-garantuesi është urdhëruar që brenda afatit prej 7 ditësh t'ia dorëzonte blerësit, kreditorit Pro Credit Bank, në posedim pronën lënë në hipotekë.

18. Më 5 dhjetor 2011 përfaqësuesi i përkohshëm i të ndjerit, së bashku me debitorin tjetër z. Afrim Kalaja, përfaqësues i N.T.P. "Ideal" nga Prishtina, kishin parashtruar Ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale E. Nr. 1168/10 të 6 tetorit 2011 dhe kanë kërkuar anulimin e këtij vendimi për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të procedurës përmbarimore.
19. Më 24 janar 2012 Gjykata e Qarkut në Prishtinë, nxori Aktvendimin Ac.nr.1496/2011 me ç'rast refuzoi si të pa bazë ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i përkohshëm i parashtruesit të kërkesës, vërteton Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë E.nr.1168/2010 i 6 tetorit 2011. Kjo gjykatë kishte konstatuar se nuk ka gjetur shkelje të procedurës përmbarimore, siç është pretenduar nga debitori, me arsyetimin që, çmimi përfundimtar i objektit të përmbarimit, pas dy shitjeve të pa suksesshme, është caktuar në kuptim të nenit 203 paragrafi 5 të Ligjit mbi procedurën përmbarimore.
20. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar prova mbështetëse që do ta arsyetonte kërkesën e tij për mos-zbulim të identitetit.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC.nr. 1496/2011 të 24 janar 2012, i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Gjykata, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.
23. Lidhur më këtë, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës që parasheh:

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

24. Gjykata, ka vërejtur që parashtruesi i kësaj kërkesë, z. Naser Peci, është në fakt përfaqësuesi i përkohshëm i të ndjerit Murat Plakolli, debitori-garantuesi i pronës së lënë në hipotekë. Përfaqësuesi i përkohshëm ishte caktuar me Vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë E.nr.1168/10, më 21 korrik 2011, që ta përfaqësonte përkohësisht të ndjerin (hipotekëlënësi) në çështjen juridike të iniciuar nga kreditori "Pro Credit Bank".

25. Duke u përgjigjur në shkresën e Gjykatës të 13 marsit 2012, parashtruesi i kërkesës ka dështuar të përgjigjet nëse trashëgimtarët e Murat Plakollit apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar ishin paraqitur në Gjykatën Komunale në Prishtinë në mbrojtje të pretendimit për pronën e tij të paluajtshme. Prandaj, duket se përfaqësuesi i përkohshëm i parashtruesit të kërkesës, të ndjerit Murat Plakolli, nuk ka provuar se gëzon të drejtën e përfaqësimit ligjor në këtë çështje, duke qenë se procedura e caktimit të trashëgimisë është e rregulluar me ligj të veçantë. Parashtruesi i kërkesës e bart barrën e të provuarit se ai apo ajo është palë e autorizuar. Në këtë kontest gjykata konsideron se i njëjti nuk mund ta përfaqësojë pronën e të ndjerit, z. Murat Plakolli, pasi që nuk ka dorëzuar në gjykatë autorizim nga radhët e trashëgimtareve ligjorë të të ndjerit Murat Plakolli apo nuk ka provuar se trashëgimtarët ligjorë nuk janë paraqitur në gjykatë në emër të pronës së Murat Plakollit.
26. Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata, konkludon që parashtrimi i kërkesës nuk është në pajtueshmëri me nenin 113 të Kushtetutës pasi që ai ka dështuar të provojë se ende është palë e autorizuar për qëllime të parashtrimit të kësaj kërkesë.
27. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse kërkesa është qartazi e bazuar dhe nëse faktet e prezantuara paraqesin bazë kushtetuese, në mënyrë që Gjykata të lëshohet me tutje në meritat e rastit.
28. Lidhur më këtë, Gjykata i referohet rregullit 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetutës që përcakton se:
- “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
- c) Kërkesa është qartazi e bazuar:*
29. Neni 46 i Kushtetutës parashikon që:
- 1. E drejta e pronës është e garantuar.*
 - 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
 - 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.*
 - 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykatat kompetente.*
30. Më 12 shtator 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë në bazë të Konkluzionit E.nr.1168/10 për Shitjen e patundshmërisë nr. UL-71914059-04949, pronë e debitorit garantuesit Murat Plakolli (hipotekëlënës), përcaktoi se kreditori Pro Credit Bank, si

blerës, ishte ofertuesi më i volitshëm që ka ofruar çmimin më të lartë të blerjes së patundshmërisë në fjalë.

31. Më 6 tetor 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë, nxori Aktvendimin E.nr.1168/10 me ç'rast konstaton se, patundshmëria e lënë në hipotekë nga i ndjeri, i është shitur kreditorit Pro Credit Bank, si ofertues i vetëm, më i volitshëm dhe që ka ofruar çmimin më të lartë për blerjen e kësaj pronë të paluajtshme. Debitori-garantuesi është urdhëruar që brenda afatit prej 7 ditësh t'ia dorëzonte blerësit, kreditorit Pro Credit Bank, në posedim pronën lënë në hipotekë.
32. Duket se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me gjetjet e fakteve dhe konkludimet e ligjit që i nxori Gjykata Komunale në rastin e tij por nuk është në gjendje të demonstrojë se si këto gjetje apo konkluzione mund t'i kenë cenuar të drejtat e tij kushtetuese.
33. Gjykata, lidhur me pretendimin e përfaqësuesit, thekson se, nuk është i mjaftueshëm arsyetimi i shkëljes së të drejtës së garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], për faktin që të njëjtit nga Gjykata Komunale në Prishtinë, i është refuzuar e drejta në ankesë për caktimin e tij si përfaqësues të përkohshëm i debitorit-garantuesit, tani të ndjerit Murat Plakolli, titullar i pronës së lënë në hipotekë.
34. Gjykata Kushtetuese, nuk është Gjykatë e verifikimit të fakteve, Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veproje si "gjykate e shkallës së katërt", (shih, *mutatis mutandis*, i.a., Akdivar kunder Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).
35. Është detyrë dhe obligim i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I). Duket se Gjykata Komunale në Prishtinë e ka kryer këtë funksion në këtë rast.
36. Gjykata Kushtetuese, nga shkresat e lëndës vëren se parashtruesi i kërkesës ka dështuar së provuari që të drejtat e tij të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës i janë shkelur, sepse faktet dhe argumentet e ofruara nga i njëjti nuk paraqesin bazë Kushtetuese të ndonjë shkeljeje procedurale të ecurisë së procesit gjyqësor në gjykatat e rregullta. Kontesti i tij pronësor është zgjidhur nga ana e një gjykate kompetente dhe nuk ka prova se ai apo personat për të cilët ai pretendon se i përfaqëson janë privuar në mënyrë arbitrare nga të drejtat e tyre pronësore.
37. Vërtet palët duhet të argumentojnë me prova, që me vendimet gjyqësore a te autoriteteve publike u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë dhe Instrumente ndërkombëtare që drejtpërdrejt janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Nëse parashtruesi nuk arrin që t'i mbështesë pretendimet e shkeljeve të garantuara me Kushtetutë, nuk është obligim i Gjykatës që të ndërtojë rastin e tij/saj. Andaj, në këtë kontest gjykata kërkesën e parashtruar do ta konsiderojë si qartazi të pabazuar.

38. Është detyrë dhe obligim i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
39. Ndërsa, sa i përket kërkesës për mbrojtjen e identitetit, përfaqësuesi nuk ka ofruar asnjë provë që do të vërtetonte se bërja publike e identitetit të tij paraqet ndonjë dem për të njëjtin, prandaj, Gjykata nuk ka gjetur bazë ligjore për ruajtjen e identitetit të përfaqësuesit dhe të ndjerit.
40. Nga arsyet e cekura me lartë, del se kërkesa e parashtruesit nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 113 të Kushtetutës, si dhe kërkesat e parapara me rregullin 36.2 (c) të rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, rregullin 36.2 (c) dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 20 qershor 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Robert Carolan



Kryetar i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani